



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 1400 Prot.

Tiranë, më 18.07.2017

V E N D I M

Nr. 166, Datë 18/07/2017

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.01.2016, të Komisionerit, nëpërmjet vendimit nr. 138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim, ka vijuar mbikëqyrja edhe pranë Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara prej ligjit, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 700 prot., datë 23.11.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën

nr. 700/1 prot., datë 23.11.2016, “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje”, i është njoftuar institucionit në fjalë.

Drejtoritë e Bujqësisë, janë subjekte që përfshihen për herë të parë në shërbimin civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktuar në parashikimet e nenit 4, pika 1, shkronja “a”, të këtij ligji. Ky fakt materializohet në mënyrë të shprehur në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 88), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar në vitin 2015.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 700/2 prot., datë 20.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të mundësuar paraqitjen e komenteve të tyre, në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Më tej, me shkresat nr. 700/3 prot., datë 20.03.2017 dhe nr. 700/4 prot., datë 20.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, me kalimin e afatit të lënë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nuk ka paraqitur observacione në lidhje me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës.

Ndërkaq, rezulton se, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, për Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje, me shkresën nr. 2322/1 prot., datë 30.03.2017, “Observacione lidhur me projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes së Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje”, ka paraqitur observacione, duke pretenduar se emërimi i Drejtorit të Bujqësisë Lushnje, ndryshe nga sa ka konstatuar grupi i punës, është kryer në përputhje me rregullat e shërbimit civil.

Në mbështetje të argumentit të tyre, në këtë rast, nga ana e këtij institucioni pretendohet se, Drejtoria e Bujqësisë Lushnje është krijuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 960, datë 25.10.2013, “Për krijimin e Drejtorive të Bujqësisë”, duke qenë se nëpërmjet këtij vendimi Drejtoritë e Bujqësisë u shtuan me një subjekt, që ishte Drejtoria e Bujqësisë Lushnje, për këtë arsye emërimi është kryer nga ministri mbi bazën e Kodit të Punës.

Nga hetimi administrativ, në lidhje me këtë pretendim, rezultoi se akti nënligjor i përmendur më sipër, ka hyrë në fuqi në datën 31.10.2013, pasi ai është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 173, datë 31.10.2013, çka shënon edhe momentin e fillimit të ekzistencës së Drejtorisë së Bujqësisë në fjalë, si subjekt më vete.

Ndërkohë, konstatohet se urdhri nr. 288, datë 28.10.2013, i Ministrit të Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** në

pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje”, ka dalë ende pa hyrë në fuqi akti nënligjor i përmendur më sipër, ç’ka e bën atë një akt absolutisht të pavlefshëm.

Ky fakt provohet edhe me përmbajtjen e aktit të emërimit, ku përcaktohet shprehimisht se, “hyrja në fuqi e këtij akti emërimi, është pas hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 960, datë 25.10.2013”.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga ana e institucionit, që ka të bëjë me këtë rast, Komisioneri sa më sipër vlerëson se, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datën 26.02.2014), kjo drejtori ende nuk ishte ndarë si një subjekt më vete, por ishte pjesë integrale e organikës dhe strukturës së Drejtorisë së Bujqësisë Fier, e organizuar në nivel sektori, e cila funksiononte mbi bazën e urdhrin nr. 79, datë 01.07.2013, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, në Qarqe”.

Me Urdhrin nr. 113, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorive të bujqësisë”, i cili në përmbajtjen e tij kishte të përcaktuar strukturën për të gjitha Drejtoritë e Bujqësisë në rrethe, është miratuar edhe struktura e Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, e cila është krijuar si njësi e re, nëpërmjet Vendimit nr. 960, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave.

Nga verifikimi i akteve të administruara rezulton se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datën 26.02.2014), punonjësi ***** ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor”, në “Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshët me OSH dhe Operatorëve të Biznesit”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Fier dhe marrëdhëniet financiare për këtë pozicion janë ndërprerë në datën 31.03.2014.

Në analizë të dokumentacionit të administruar, si dhe të observacioneve të ardhura nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Komisioneri vlerëson se pretendimet e institucionit në këtë rast nuk qëndrojnë, pasi në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, emërimi i punonjësit ***** në pozicionin e punës së Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë në fjalë, duhej të bëhej në zbatim të procedurave të konkurrimit të përcaktuara në nenin 26, të këtij ligji, ku parashikohet plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.

Në këtë rast, Departamenti i Administratës Publike, duhet të kishte shpallur procedurat për plotësimin e pozicionit të lirë, në përputhje me ligjin dhe ky punonjës duhet të shprehte vullnetin e tij për të qenë pjesë e kësaj procedure, ç’ka nuk provohet të ketë ndodhur.

Në këto rrethana, vlerësoj se, duhet të mbetet konkluzioni i nxjerrë në projektraportin e dërguar institucionit, ku është analizuar me hollësi rasti dhe qëndrimi që duhet të mbahet për të rregulluar ligjshmërinë.

Sa më sipër, çmoj se nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në përfundim, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në kuptim të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të drejtojë procesin e deklarimit të statusit të punësimin për punonjësit të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, ishin të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të përshkrimit të pozicionit të punës. Për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

a. Të verifikojë përmbushjen e kriterëve dhe më tej, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimin për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier, i cili sipas verifikimeve të Komisionerit, i përket kategorisë “Nëpunës civil në periudhë prove”.

Më tej, në kuptim të nenit 24, të ligjit për nëpunësin civil, titullari i Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, në cilësinë e eprorit direkt, duhet të finalizojë procesin e konfirmimit si nëpunës civil, pas përfundimit të periudhës së provës.

b. Të verifikojë përmbushjen e kriterëve dhe më tej, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimin për punonjësit:

✓ *****, për pozicionin “Inspektor”, në “Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshët me OSH dhe Operatorëve të Biznesit”, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier;

✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Sektorin e Administratës, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Shërbimit Këshillimor*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*” në “*Sektorin e Shërbimit Këshillimor*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*” në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

✓ *****, për pozicionin “*Specialist*” në “*Sektorin e Shërbimit Këshillimor*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier,

të cilët, sipas verifikimeve të kryera nga Komisioneri, i përkasin kategorisë “*Nëpunës civil*”.

3. Të kërkojë nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të anulojë urdhrin nr. 288, datë 28.10.2013, “*Për emërim dhe lirim nga detyra*”, të punonjësit *****, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje dhe të ndërpresë marrëdhënien e tij financiare, në lidhje me këtë pozicion pune, bazuar në detyrimin ligjor, të parashikuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 108 dhe 113, të po këtij ligji.

Në lidhje me këtë rast, Departamenti i Administratës Publike duhet të shpallë të lirë vendin e punës, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje dhe më tej, të vijojnë procedurat për plotësimin e tij në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Duke u nisur nga fakti, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, punonjësi në fjalë, ka qenë i emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në “*Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshët me OSH dhe Operatorëve të Biznesit*”, të Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Fier, Departamenti i Administratës Publike, të finalizojë procedurat e deklaramit të statusit të tij të punësimit, ashtu si parashikohet në pikën 1, të këtij vendimi. Mbi bazën e këtij statusi duhet të vlerësohet edhe mundësia e sistemimit të tij pas ristrukturimit, në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje.

4. Departamenti i Administratës Publike, në bazë të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, duhet të finalizojë procesin e ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, për shkak të miratimit të strukturës së re, me urdhrin nr. 54, datë 22.04.2015, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorive të bujqësisë*”.

Për të rregulluar gjithë situatën e paligjshmërisë të krijuar në këtë institucion, duke nisur nga momenti i fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, duhet të veprojë sipas këtij rendi pune:

Së pari, të verifikojë nëse nëpunësit aktualë të këtij institucioni i plotësojnë kushtet për të përfituar nga të drejtat që i ka dhënë ligji për nëpunësin civil, punonjësve që u gjenden në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Së dyti, të gjithë punonjësit që përmbushin kushtet si më sipër, duhet të trajtohen në kuadër të institutit të transferimit të përhershëm dhe të sistemohen në pozicionet e punës të materializuara në strukturën e institucionit duke analizuar nëse ata i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe specifike për pozicionin përkatës të punës dhe më pas, duke nxjerrë aktet individuale të emërimit për secilin punonjës.

Së treti, pasi të kryejë verifikimin e kushteve ligjore për punonjësit që më parë kanë qenë pjesë e Drejtorisë së Bujqësisë Fier, duhet të përmyllë procesin e ristrukturimit, sipas propozimeve të dërguara nga Komisioni i Ristrukturimit dhe të nxjerrë menjëherë aktet e transferimit të përhershëm të tyre, në pozicionet përkatëse të institucionit të ri, ku atyre i kanë kaluar funksionet, në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje.

Bëhet fjalë për punonjësit, të cilët në momentin e krijimit të institucionit të ri, kanë qenë në këto pozicione pune:

- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier.
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Shërbimit Këshillimor”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Veterinarisë”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Veterinarisë”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “Specialist”, në “Sektorin e Veterinarisë”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;

- ✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier;
- ✓ *****, për pozicionin “*Specialist*”, në “*Sektorin e Veterinarisë*”, në Drejtorinë e Bujqësisë Fier.

5. Të finalizohet procedura e përfundimit të periudhës së provës, nëpërmjet nxjerrjes së akteve individuale të konfirmimit si nëpunës civil për punonjësit ***** dhe *****, të emëruar në Sektorin e Shërbimit Këshillimor, në pozicionin e punës, “*Specialist për statistikën*”.

➤ Vendimi i konfirmimit si nëpunës civil duhet t’i njoftohet nëpunësve të mësipërm dhe një kopje e tij të depozitohet në dosjen e tyre personale.

➤ Drejtoria e Bujqësisë Lushnje, duhet t’i komunikojë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, vendimet e konfirmimit si nëpunës civil, në përfundim të periudhës së provës, për këta punonjës.

➤ Departamenti i Administratës Publike, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit ***** dhe *****.

6. Njësia përgjegjëse (DAP) duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil për punonjësin *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shërbimit Këshillimor*”, liruar me vendimin nr. 1, datë 08.04.2016, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, për shkak të dorëheqjes dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, t’i njoftohet e drejta që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, mund të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të këtij ligji, duke i filluar ky afat nga momenti që i lind e drejta.

7. Njësia e burimeve njerëzore, pranë Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, në kuptim të nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, duhet të organizojë dhe të plotësojë dosjet e personelit me aktet e deklarimit të statusit të punësimit dhe të akteve që materializojnë procedurën e ristrukturimit, që kanë të bëjnë me emërimin përfundimtar të punonjësve në Drejtorinë e Bujqësisë Lushnje.

8. Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore në institucionin e mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes që, për çdo procedurë që ka lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, të bëjnë administrimin e tyre edhe në mënyrë shkresore, sipas kërkesave të ligjit, me qëllim kontrollin e zbatimit të tij, gjatë administrimit të shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesuar që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej të depozitohet ato, në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

9. Njësia e burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, në lidhje me procesin e planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të mbajë parasysh rastet e mbushjes së moshës së pensionit, parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil dhe të marrin masa për realizimin e tij, në përputhje me afatet dhe procedurat respektive, të parashikuara në mënyrë të detajuar në pikën 5, 7 dhe 8, të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.

10. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur, njësia përgjegjëse, si dhe subjekte të tjera të ngarkuar për kryerjen e veprimeve të caktuara administrative në këtë vendim, duhet ta zbatojnë atë, duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

11. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Bujqësisë Lushnje, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

12. Për këtë vendim të njoftohet Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Sekretari i Përgjithshëm i këtij institucioni, Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Lushnje, si edhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes. Njëkohësisht, të informohet edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

13. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA